



POROSI
TË IMAM KADHIMIT
(Paqja qoftë mbi të!)
PËR HISHAMIN

Tiranë, 2023

për Hishamin

Titulli i librit: **Porosi të Imam Kadhimit**

(*Paqja qoftë mbi të!*) **për Hishamin**

I tuboi dhe i përktheu:

Haxhi Shejkh Vullnet Merja

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: Shoqata "Flladi"- Tiranë, 2023

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!

Es Selamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu!

(Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ju!)

FJALA HYRËSE

Fjalori i gjuhës shqipe, shpjegimin e fjalës “këshillë”, e jep: *këshill/ë,-a emër i gjinisë femërore; numri shumës; -a(t) porosi a mendim që i jepet dikujt për ta ndihmuar ose për ta mësuar si duhet të veprojë, si të sillet etj.: këshillë prindërore (e urtë); dëgjoj (zbatoj) këshillat e mjekut. Me pak fjalë, kuptimi i kësaj fjale është që t’i tregosh dikujt të mirën, që t’i zbutet zemra.*

Në Kur’an kjo fjalë është përdorur për të zgjuar ndërgjegjen dhe ndjenjat e njeriut. Me anë të këshillës, këshilluesi i

drejtohet intelektit, ndërgjegjes, emocioneve, sepse shumicën e njerëzve, e vënë në lëvizje më së shumti emocionet dhe epshet. Të paktë janë ata që vihen në lëvizje nga intelekti apo mendja e shëndoshë. Kështu që këshilla fetare luan rol të madh. Për këtë çështje Kur'ani thotë:

“ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ...”

“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur...”¹

Në jetën tonë të përditshme ne kemi nevojë për këshilla në çdo fushë të jetës. Pa dyshim që këshilla dhe porosia më e mirë është ajo e Krijuesit tonë, Allahut të

¹ Sure “En Nahl”, ajeti 125.

Plotfuqishëm, që na i ka shpallur në Librin epokbërës, përmyllësin e librave qiellorë, mrekullia e përjetshme për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), Kur'ani i Shenjtë, për të cilin Allahu thotë:

{اللَّهُ تَزَلَّ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُتَشَابِهًا مَثَابًا تَشْعُرُ مِنْهُ جُلُودَ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَى ذِكْرِ اللَّهِ ذَلِكَ هُدَى اللَّهِ يَهْدِي بِهِ مَنْ يَشَاءُ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَتَا لَهُ مِنْ هَادٍ}

“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu. Ky Libër

është udhëzim i Allahut. Njëpërmjet tij Allahu udhëzon kë të dojë. Ndërsa atë që Allahu e shpie në humbje, s'mund ta udhëzojë kush".²

Për këshillën dhe porosinë, Kur'ani na sjell si shembuj profetët dhe të dërguarit e Tij, si dhe njerëzit e urtë e punëmirë, siç është Lukmani i urtë, i cili porosiste dhe e këshillonte djalin e tij, duke i thënë:

﴿وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ...
يَا بُنَيَّ إِنَّمَا إِن تَكُ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِنْ حَرْدَلٍ فَمَتَّكِنٌ فِي صَخْرَةٍ أَوْ فِي السَّمَاوَاتِ أَوْ فِي
الْأَرْضِ يَأْتِ بِهَا اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ لَطِيفٌ خَبِيرٌ يَا بُنَيَّ أُقِمِ الصَّلَاةَ وَأْمُرْ بِالْمَعْرُوفِ وَانْهَ
عَنِ الْمُنْكَرِ وَاصْبِرْ عَلَى مَا أَصَابَكَ إِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ وَلَا تُصَوِّرْ خَدَّكَ

²Sure "Ez Zumer", ajeti 23.

لِلنَّائِسِ وَلَا تَمْشِي فِي الْأَرْضِ مَرَحًا إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ وَاقْصِدْ فِي مَشْيِكَ وَاعْظُمْ مِنْ صَوْتِكَ إِنَّ أَنْكَرَ الْأَصْوَاتِ لَصَوْتُ الْحَمِيرِ

“(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: ‘O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe...’”³

“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë. O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të

³Sure “Lukman”, ajeti 13.

vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve! Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët! Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”⁴

Sa të mrekullueshme këto këshilla e porosi të Lukmanit të urtë! Janë të mbushura me mësim dhe udhëzime. Ne e falënderojmë Allahun që na ka bërë prej pasuesve të këtij libri të Shenjtë, i cili është dritë, mëshirë, udhëzim e ndërmjetësim.

⁴Sure “Lukman”, ajetet 16-19.

Ne kemi porosinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilat janë udhërrëfyese për në mirësi, paqe, vëllazëri, dashuri, respekt e lumturi, jo vetëm për myslimanët, por për mbarë njerëzimin, sepse ai ishte “Kur’ani folës” dhe çdo gjë që ai fliste, ishte mesazh i shpallur, siç na thotë Kur’ani:

{وَمَا يَطَّلِقُ عَنِ الْهَوَىٰ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ عَلَّمَهُ شَدِيدُ الْقُوَىٰ}

“Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar

atij një (engjell) shumë i fuqishëm (Xhebraili)”⁵

Në literaturën islame gjejmë porosi e këshilla të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), për Ebu Dherr El Gifarin (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) e shumë e shumë porosi, që ai u ka dhënë sahabëve.

Prej porosive dhe këshillave të ndritura janë edhe ato të imamëve të Ehli Bejtit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në këtë libërth kemi përzgjedhur dhe kemi

⁵Sure “Nexhm”, ajetet 3-5.

përkthyer 70 këshilla e porosi të imam Musa el Kadhimit (*Paqja qoftë mbi të!*) për ndjekësin e tij, Hisham ibn Hakemin.

E lusim Allahun që këto porosi e këshilla të ndihmojnë sadopak në udhëzimin drejt mirësisë! Allahu na i pranofte veprat dhe sakrificat!

Shoqata "Fladi"

Porosi të Imam Kadhimit *(Paqja çoftë mbi të!)*

POROSI
TË IMAM KADHIMIT
(Paqja çoftë mbi të!)
PËR HISHAMIN

1- Imam Kadhimi (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Allahu i Bekuar dhe i Lartësuar i ka përgëzuar në Librin e Tij personat me intelekt: **”...‘jepu lajme të gëzueshme robëve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhet), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët’”**.⁶

2- O Hisham! Allahu i Madhëruar e i Lartësuar i ka përsosur argumentet për njerëzit me intelekt, i ka informuar për

⁶Sure “Ez Zumer”, ajetet 17-18.

sqarimin dhe i ka udhëzuar në mbizotërimin e Tij me fakte. Ai ka thënë: **“Zoti juaj është një Zot i vetëm! S’ka zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt”.**⁷

⁷ Sure “El Bekare”, ajetet 163-164.

3- O Hisham! Allahu i Madhëruar ka dhënë shenja të qarta për njohjen e Tij, duke na treguar se ka një Administrues: **“Ai ka bërë që ju ta shfrytëzoni natën dhe ditën, Diellin dhe Hënë. Edhe yjet janë vënë në shërbimin tuaj me urdhrin e Tij. Njëmend, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë”**.⁸

Në ajetet 1-3 të sures “Ez Zukruf”, thuhet: **“Hâ, Mîm. Betohe në Librin e qartë! Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kur’anin në gjuhën arabe që ju të arsyetoni”**.

⁸Sure “En Nahl”, ajeti 12.

Gjithashtu, në ajetin 24 të sures “Er Rrum”, thuhet: **“E prej shenjave të Tij janë paraqitja e vetëtimës si frikë e shpresë dhe dërgimi i shiut prej qiellit, që nëpërmjet tij të gjallërohet toka pas shkretimit të saj. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë”**.

4- O Hisham! Allahu i këshilloi njerëzit me intelekt dhe i bëri dëshirues për Ahiretin. Ja një këshillë prej Tij: **“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse Bota Tjetër, pa dyshim që është më**

e mirë për ata që i frikësohen Allahut. Pra, a nuk po mendoni?”⁹

Dhe ka thënë: “Çdo gjë që ju është dhënë juve, ajo është kënaqësi e kësaj jete dhe stoli e saj, ndërsa ajo që është tek Allahu, është më e mirë dhe më e përhershme. Vallë, a nuk e kuptoni?!”¹⁰

5- O Hisham, më pas i frikësoi ata që nuk arsyetojnë me dënimin e Tij. Allahu i Madhëruar dhe i Lartësuar u tha atyre: “Pastaj i zhdukëm të tjerët. Ju që kaloni

⁹ Sure “El En’am”, ajeti 32.

¹⁰ Sure “Kasas”, ajeti 60.

pranë rrënojave të tyre në mëngjes dhe natën, a nuk po e arsyetoni?”¹¹

6- O Hisham! Allahu sqaroi se intelekti është i shoqëruar me dijen: **“Këta shembuj Ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i arsyeton askush, përveç dijetarëve”.**¹²

7- O Hisham! Allahu i qorton ata që nuk arsyetojnë dhe thotë: **“Kur atyre u thuhet: ‘Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!’, ata përgjigjen: ‘Jo! Ne do të**

¹¹ Sure “Es Safat”, ajetet 136-138.

¹² Sure “El Ankebut”, ajeti 43.

ndjekim atë udhë, në të cilën i kemi gjetur të parët tanë' - Vallë, edhe atëherë kur të parët e tyre nuk arsyetonin asgjë e nuk ishin të udhëzuar?!"¹³

"Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj së vërtetës) e që nuk arsyetojnë".¹⁴

Dhe: "E nëse i pyet ata: 'Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?', me siguri që do të të thonë: 'Allahu!'. Atëherë ti thuaju: 'Qoftë lavdëruar Allahu!' Por, shumica e tyre nuk dinë".¹⁵

¹³ Sure "El Bekare", ajeti 170.

¹⁴ Sure "El Bekare", ajeti 22.

¹⁵ Sure "Lukman", ajeti 25.

Pastaj Ai e qorton shumicën dhe thotë: **“Nëse i bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e Allahut...”**¹⁶

Dhe: **“Por shumica e tyre nuk e dinë”**.¹⁷

Dhe: **“Shumica e njerëzve nuk falënderojnë”**.¹⁸

8- O Hisham, pastaj Allahu lavdëron pakicën dhe thotë: **“Pak nga**

¹⁶ Sure “El En’am”, ajeti 116.

¹⁷ Sure “Junus”, ajeti 55.

¹⁸ Sure “Gafir”, ajeti 61.

robërit e Mi, janë falënderues”.¹⁹ “Por shumë të paktë ishin ata që i kishin besuar atij!”²⁰

9- O Hisham! Allahu i përmend personat me intelekt me fjalët më të mira dhe i zbukuroi me stolinë më të mirë (urtësinë). Ja se çfarë thotë për ta: **“Ai ia jep urtësinë kujt të dojë. Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç poseduesve të të intelektit”.**²¹

¹⁹ Sure “Es Sebe”, ajeti 13.

²⁰ Sure “Hud”, ajeti 40.

²¹ Sure “El Bekare”, ajeti 269.

10- O Hisham! Allahu thotë:
“Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër...”²², që do të thotë ai që ka intelekt.

Dhe **“Ne i dhamë Lukmanit urtësinë...”**, që do të thotë të kuptuarit dhe intelektin.

11- O Hisham! Lukmani i tha djalit të tij: “Ji i thjeshtë, i përlurur para të drejtës, të vërtetës, që të jesh njeriu më intelektual! O biri im! Dynjaja është një det i thellë. Në të janë mbytur shumë njerëz. Le të jetë

²² Sure “Kaf”, ajeti 37.

devotshmëria ndaj Allahut anija jote në dynja, mbushja e saj të jetë besimi, vela e saj mbështetja te Allahu, timoni i saj intelekt, udhëzuesi i saj dituria dhe banorët e saj durimi”.

12- O Hisham! Për çdo gjë ka tregues dhe treguesi i atij që ka intelekt, është të menduarit, ndërsa treguesi i të menduarit është heshtja. Për çdo gjë ka një mjet dhe mjeti i intelektualit është thjeshtësia. Ty të mjafton padituria, që të marrësh për mjet atë që të është ndaluar.

13- O Hisham! Allahu i dërgoi profetët dhe të dërguarit e Tij te robtë e Vet vetëm e vetëm që ata të arsyetojnë rreth Allahut. Më i miri prej tyre në përgjigje është ai që e njeh më mirë Allahun, më i njohuri i tyre për urdhrin e Allahut është më intelektual i tyre dhe më intelektual i tyre është në shkallë më të lartë se ata në dynja dhe në Ahiret.

14- O Hisham! Për çdo rob ka një engjëll që e kap prej ballukesh. Kur bëhet modest, Allahu e lartëson, kur hiqet si madhështor, Allahu e ul (e zvogëlon).

15- O Hisham! Allahu ka dy argumente për njerëzit, një argument të jashtëm dhe një argument të brendshëm. Për sa i përket argumentit të jashtëm, ai është: të dërguarit, profetët dhe imamët. E për sa i përket argumentit të brendshëm, ai është intelekt.

16- O Hisham! Njeriu që ka intelekt është gjithmonë falënderues për atë që ka. E ndaluara (harami) nuk e mposht durimin e tij.

17- O Hisham! Kush kontrollon tre mbi tre, është sikur të ketë ndihmuar

dëshirat e tij për të shkatërruar intelektin e tij. Ai që errëson dritën e mendimit të tij me gjatësinë e shpresës së tij, fshin marifetet e mençurisë së tij me kureshtjen e fjalëve të tij dhe shuan dritën e reflektimit të tij me dëshirat e veta, është sikur të ndihmonte dëshirat e tij, që t'i shkatërronin intelektin. Kushdo që shkatërron intelektin, ka prishur fenë (besimin) dhe dynjanë e tij.

18- O Hisham! Si do të jetë e pastër puna jote te Allahu, kur ti e shfrytëzove intelektin tënd për çështje që nuk kanë lidhje me Zotin tënd dhe iu binde dëshirës tënde për të mposhtur intelektin tënd?!

19- O Hisham! Durimi ndaj vetmisë është shenjë e fuqisë së intelektit. Kushdo që mendon në emër të Allahut, qoftë i bekuar dhe i lartësuar, largohet nga njerëzit e kësaj bote, nga dëshiruesit e saj dhe dëshiron ato që ka Zoti i tij. Allahu do të jetë shoqëruesi i tij në vetmi, pasuria e tij në familje dhe fuqia e tij, kur nuk është në prani të fisit.

20- O Hisham! Njeriu me intelekt kënaqet me pak nga kjo botë e me urtësi dhe nuk është i kënaqur me pak urtësi e me gjëra të shumta të dynjanë, prandaj tregtia e tij është fitimprurëse.

21- O Hisham! Nëse të pasuron ajo që të mjafton, atëherë të mjafton minimumi i asaj në këtë botë. E nëse nuk të pasuron ajo që të mjafton, atëherë asgjë nga dynjaja nuk të pasuron.

22- O Hisham! Të mençurit janë larguar nga kjo botë dhe kanë dëshiruar Ahiretin, sepse e kanë ditur se dynjaja është kërkesë e kufizuar. Kushdo që kërkon Botën Tjetër, kjo botë do ta kërkojë atë, deri sa të marrë furnizimin e tij prej saj; kushdo që kërkon këtë botë, atë do ta kërkojë Bota Tjetër, pastaj do t'i vijë vdekja dhe do t'ia shkatërrojë këtë botë dhe Botën Tjetër.

23- O Hisham! Kushdo që dëshiron pasuri pa para, qetësi të zemrës nga smira dhe siguri në fe, le t'i përgjërohet Allahut në lutjen e tij, që t'i plotësojë intelektin. Ai që ka intelekt, është i kënaqur me atë që i mjafton; ai që është i kënaqur me atë që i mjafton, bëhet i pasur, ndërsa ai që nuk është i kënaqur me atë që i mjafton, nuk do ta arrijë kurrë pasurinë.

24- O Hisham! Allahu i Madhëruar e i Plotfuqishëm flet për njerëzit punëmirë se ata thonë: **“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë,**

dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!”²³ Zemrat shmangen dhe kthehen të verbëria dhe mbulimi i tyre. Ai që nuk arsyeton rreth Allahut, nuk i frikësohet Atij. Ai që arsyeton rreth Allahut, në zemrën e tij nuk ka njohje të palëkundshme. Me anë të saj do ta kuptojë e do ta gjejë të vërtetën. Askush nuk është kështu përveç atij që thënia e tij vërteton veprën e tij dhe e fshehta e tij është në përputhje me të jashtmen e tij, sepse Allahu nuk e tregon të brendshmen e fshehur të inteligjencës veçse nëpërmjet të jashtmes së personit dhe nëpërmjet asaj që ai flet.

²³ Sure “Ali Imran”, ajeti 8.

25- O Hisham! Ai që thotë të vërtetën me gjuhën e tij, veprat i pastrohen; ai që ka qëllim të mirë, i shtohet furnizimi dhe ai që është i sjellshëm me vëllezërit dhe familjen e tij, i zgjatet jeta.

26- O Hisham! Mos ia jepni urtësinë injorantit, sepse do t'i bëni padrejtësi asaj (urtësisë). As mos e pengoni atë (urtësinë) prej merituesve të saj, sepse do t'u bëni padrejtësi atyre.

27- O Hisham! Siç iu lanë urtësinë, lërinia atyre dynjanë.

28- O Hisham! Nuk ka fe për atë që nuk ka mirësjellje dhe nuk ka mirësi për atë që nuk ka intelekt. Njeriu më i madh në vlerë është ai që nuk e sheh botën si rrezik për veten e tij. Për sa u përket trupave tuaj, nuk ka çmim për ta përveç Xhenetit, prandaj mos i shitni për asgjë tjetër.

29- O Hisham! Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thoshte se në krye të kuvendit ulet vetëm një burrë me tri cilësi: përgjigjet, kur pyetet; bisedon, kur populli nuk mund të japë përgjigje; jep mendimin, në të cilin ka mirësi familja e tij.

Nëse nuk ka asgjë nga këto dhe ulet në krye të kuvendit, ai është budalla (ahmak).

- Nëse kërkoni nevoja, kërkoni nga ata që e meritojnë, - ka thënë Hasan ibn Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).

- O biri i të Dërguarit, cilët janë ata meritues? - e pyetën.

- Janë ata që Zoti i ka rrëfyer në Librin e Tij: **“njerëzit që kanë arsye, ia vënë veshin kësaj”**. (Sure Rra'd, ajeti 19) - u përgjigj ai. - Ata janë njerëzit që kanë intelekt.

30- O Hisham! Ali ibn Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Qëndrimi me të mirët fton në mirësi. Edukata e dijetarëve është rritja e intelektit. Bindja ndaj sunduesve të drejtësisë është krenari. Investimi i pasurisë është morali i mirë. Udhëzimi i këshilltarit për të vënë në vend të drejtën është mirësi. Heqja dorë nga lëndimi është prej plotësimit të intelektit dhe në të ka rehati për trupin herët e vonë”.

31- O Hisham! Njeriu që ka intelekt, nuk flet me atë që i frikësohet përgënjeshtimit të tij. As nuk e pyet atë që nuk i përgjigjet, as nuk premton për atë që nuk mund ta bëjë, as nuk shpreson atë që

ai mund të qortohet nga shpresa e tij, as përparon për atë që i frikësohet paaftësisë ndaj saj.

32- O Hisham! Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i porosiste shokët e tij dhe u thoshte: “Ju porosis që t’i frikësoheni Allahut në fshehtësi dhe hapur. Jini të drejtë, si kur jeni të kënaqur, ashtu edhe kur jeni të zemëruar. Fitoni, kur jeni në varfëri dhe në bollëk. Mbani lidhje me ata që i shkëpusin lidhjet me ju. Faleni atë që ju bën zullum. Bëhuni të dhembshëm me atë që ju privon. Shikimi juaj le të jetë kalimtar, heshtja juaj meditim, thënia juaj përmendje, natyra juaj bujare, sepse

koprraci nuk hyn në Xhenet e as bujari nuk hyn në zjarr”.

33- O Hisham! Gjëja më e mirë me të cilën një rob i afrohet Allahut, pas njohjes së Tij, është namazi, nderimi i prindërve, braktisja e smirës, krenarisë dhe mendjemadhësisë.

34- O Hisham! Njeriu i mençur nuk gënjen, edhe nëse në të (gënjeshtren) gjendet dëshira e tij.

35- O Hisham! Të gjithë njerëzit i shohin yjet, por me to nuk udhëzohet askush përveç atyre që e njohin lëvizjen dhe pozitën e tyre. Po ashtu jeni edhe ju. E studioni urtësinë, por askush prej jush nuk udhëzohet me të, përveç atyre që veprojnë sipas saj.

36- O Hisham! Njeriu nuk është besimtar, deri sa të jetë i frikësuar dhe shpresues. As nuk mund të jetë i frikësuar dhe shpresues, deri sa të jetë veprues i asaj që i frikësohet dhe i asaj që ai shpreson.

37- O Hisham! Shembulli i dynjasë është si gjarpri. Prekja e tij është e butë, por brenda tij ka helmin vdekjeprurës. Njeriu që ka intelekt, bën kujdes prej tij, ndërsa djemtë anojnë kah ai me duart e tyre.

38- O Hisham! Dynjaja është si uji i detit, sa herë që i eturi pi nga ai, i shtohet etja, deri sa ajo (etja) ta vrasë atë.

39- O Hisham! Turpi është nga besimi dhe besimi është në Xhenet. Gojëkeqja është prej vrazhdësisë (ngurtësisë) dhe ngurtësia është në Xhehenem.

40- O Hisham! Bëhu i butë, sepse butësia është mirësi dhe dhunimi është fatkeqësi. Butësia, mirëbërja dhe morali i mirë i gjallërojnë shtëpitë dhe e shtojnë furnizimin.

41- O Hisham! Nuk është prej nesh ai që nuk e llogarit veten e tij çdo ditë. Nëse ka bërë vepër të mirë, të kërkojë që t'i shtohet, e nëse ka bërë një të keqe, t'i kërkojë falje Allahut dhe të pendohet te Ai.

42- O Hisham! Ruhu nga mendjemadhësia, sepse nuk hyn në Xhenet ai që ka në zemrën e tij një grimcë mendjemadhësie. Madhështia është petku i Allahut dhe kushdo që ia zhvesh Atij petkun, Allahu do ta hedhë me fytyrë në zjarr.

43- O Hisham! Sa e shëmtuar është varfëria pas pasurisë dhe sa i shëmtuar është mëkati pas asketizmit! Më e shëmtuar se këto është adhuruesi i Allahut, që e braktis adhurimin e Tij!

44- O Hisham! Nuk ka asnjë mirësi në jetë përveç se për dy persona: dëgjuesi i vëmendshëm dhe dijetari folës i të drejtës, i të vërtetës.

45- O Hisham! Bëhu i durueshëm në bindjen ndaj Allahut dhe bëhu i durueshëm në mosbindjen ndaj Allahut, sepse kjo botë është vetëm një orë. Prej atyre që kanë kaluar prej saj, nuk do të gjesh as lumturi e as pikëllim. Ti nuk e di se çfarë do të vijë, prandaj bëhu i durueshëm në çdo kohë, sikur të jesh i bekuar.

46- O Hisham! Njeriu intelektual e i zgjuar është ai që nuk vepron diçka për të cilën nuk ka fuqi. Shpërblimi më i shumtë është në kundërshtimin e egos. Ai që shpreson gjatë, bën punë të këqija.

47- O Hisham! Kush e do këtë botë, frika e Ahiretit do të ikë nga zemra e tij. Atij njeriu që i është dhënë dituria dhe i shtohet dashuria për këtë botë, largohet më shumë nga Allahu dhe zemërimi i Allahut ndaj tij shtohet.

48- O Hisham! Mëso nga dituria atë që nuk e dije dhe mësoji të paditurit ato që

ti mësove. Madhështoje dijetarin për dijen e tij dhe lëre grindjen me të. Nënçmoje injorantin për injorancën e tij dhe mos e largo atë, por afroje dhe mësoje atë.

49- O Hisham! Folësit janë tre: fituesi, paqësori dhe kritikuesi. Për sa i përket fituesit, është ai që e përmend Allahun. Paqësori, është ai që hesht, kurse kritikuesi është ai që merret me të kota. Allahu ia ka ndaluar Xhenetin çdo njeriu të paturpshëm, të shthurur e gojëkeq, që nuk i intereson se çfarë thotë apo çfarë thuhet për të. Ebu Dherri (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) thoshte: “O kërkues i diturisë! Gjuha është çelësi i të mirës dhe i të keqes.

Prandaj, ruaje gjuhën tënde, siç ruan arin tënd dhe paranë tënde”.

50- O Hisham! Ndreqi ditët e tua që janë para teje dhe shiko se çfarë dite është dhe përgatiti asaj përgjigjen, sepse ti do të dalësh para Allahut dhe do të jesh përgjegjës për veprat e asaj dite. Merri këshillat e tua nga koha dhe nga njerëzit e saj. Vërtet, koha është e gjatë dhe e shkurtër, prandaj puno sikur e sheh shpërblimin e punës tënde, që të jesh më lakmuesi në këtë. Arsyeto rreth Allahut dhe shiko sjelljen e kohës dhe rrethanat e saj. Padyshim, ajo që vjen nga kjo botë,

është si ajo që u largua prej saj, prandaj merre në konsideratë atë.

51- O Hisham! Ali ibn Hysejni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Çdo gjë mbi të cilën lind dielli, në lindje dhe perëndim të dynjasë, në detin dhe tokën e saj, në fushat dhe malet e saj, për një të dashur prej të dashurve të Allahut dhe për atë që di të vërtetën për Allahun, është e barabartë me hijen. A nuk ka njerëz të lirë, që ta lenë këtë mbeturinë të ushqimit për banorët e saj, për dynjanë?” Për veten tuaj nuk keni çmim tjetër përveç Xhenetit, prandaj mos e shitni për tjetër gjë, veçse për të. Kushdo që është

i kënaqur me Allahun për këtë botë (dynjanë), është i kënaqur me të keqen.

52- O Hisham! Në Bibël është shkruar: “Lum të mëshirshmit, sepse ata do të mëshirohen në Ditën e Kiametit. Lum ata që bëjnë pajtim mes njerëzve, sepse ata do të jenë të afërm (te Allahu) në Ditën e Kiametit. Lum ata, zemrat e të cilëve janë pastruar -ata janë të devotshmit në Ditën e Kiametit. Lum të përulurit (modestët) në këtë botë, në Ditën e Kiametit, do të ngjiten në podiumet mbretërore!”

53- O Hisham! Sa njeri i keq është ai me dy gjuhë dhe me dy fytyra. Ai e lajkaton vëllain e tij, kur e sheh dhe e ha atë, kur ai mungon; kur i jepet (e mira), ka smirë për atë dhe, kur sprovohet, e poshtëron atë. Shpërblimi më i shpejtë për të mirën është mirësia, ndërsa dënimi më i shpejtë për të keqen është agresioni. Më i keqi prej robëve të Allahut është ai që qëndrimi me të nuk pëlqehet, për shkak të paturpësisë së tij. A nuk do të hidhen në zjarr njerëzit me fytyrat e tyre, veçse për shkak të asaj që korrin gjuhët e tyre? Prej mirësisë së fesë së një njeriu është të braktisë ato që nuk i interesojnë.

54- O Hisham! Çdo mirësi që nuk mund ta falënderosh, është në pozitën e të keqes dhe do të ndëshkohesh për të. Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Ka rob të Allahut, të cilëve u thyhet zemra nga frika e Tij, prandaj ata heshtin para logjikës. Ata janë elokuentë e të arsyeshëm. Garojnë drejt Allahut me vepra të pastra, nuk i kërkojnë shumë Atij dhe as nuk janë të kënaqur me të paktën e vetes së tyre. Ata mendojnë për veten tyre se janë të këqij, por, në të vërtetë, ata janë mendjemprehtët dhe të mirët”.

55- O Hisham! Të mbjellat rriten lehtë në tokë dhe jo në shkëmb. Po kështu

edhe urtësia. Ajo rritet në zemrën e modestit dhe nuk rritet në zemrën e mendjemadhrit tiran. Allahu e ka bërë modestinë mjet të intelektit, kurse mendjemadhësinë mjet të injorancës. A nuk e ke parë atë që i bie tavanit me kokën e tij dhe e çan atë?! Ai që e ul kokën, hijezon çka nën të dhe e mbulon atë. Kush bëhet modest ndaj Allahut, Ai e ngre atë dhe, kush bëhet mendjemadh ndaj Allahut, Ai e lartëson atë.

56- O Hisham! i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Nëse sheh një besimtar të heshtur, afroju atij, se ai lëshon

urtësi". Besimtari flet pak dhe punon shumë, kurse hipokriti flet shumë dhe punon pak.

57- O Hisham! Sikur të kishe një arrë në dorë dhe njerëzit të të thoshin se është një margaritar, nuk do të të sillte asnjë dobi fjala e tyre, sepse ti e di, se ajo është vetëm një arrë. Sikur të kishe një margaritar në dorë dhe njerëzit të të thoshin se është një arrë, nuk do të të bënte dëm fjala e tyre, sepse ti e di, se ajo është një margaritar.

58- O Hisham! Njerëzit janë krijuar për t'iu bindur Allahut dhe nuk ka shpëtim

përveçse me bindje. Bindja është me dituri dhe dituria është me të mësuar e me mësimdhënie. Me intelekt besohet. Nuk ka dituri përveçse nga një dijetar hyjnor dhe njohja e dijetarit arrihet përmes intelektit.

59- O Hisham! Vepra e paktë nga të mençurit është e pranueshme dhe e shumëfishuar, kurse vepra e madhe nga njerëzit e dëshirës dhe e injorancës është e refuzuar.

60- O Hisham! Allahu e mëshiroftë atë që ka turp nga Allahu, duke ruajtur kokën dhe atë që përmban, stomakun dhe

atë (ushqimin) që e mbush, kujton vdekjen dhe sprovën, e di se Xheneti është i rrethuar me vështirësi dhe Xhehenemi është i rrethuar me dëshira e epshe.

61- O Hisham! Kush e frenon veten nga nderi i njerëzve, Zoti do t'ia pakësojë të këqijat në Ditën e Kiametit. Kush e frenon zemërimin e tij ndaj njerëzve, Allahu do t'ia frenojë zemërimin e Tij në Ditën e Kiametit.

Besimtari është si dy anët e peshores, sa më shumë t'i rritet atij besimi, aq më shumë i shtohen sprovat.

62- O Hisham! Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thoshte se nuk ka asgjë që e adhuron Allahun më mirë se intelekti. Intelekti i një personi nuk është i përsosur vetëm kur në të gjenden cilësi të ndryshme. Mosbesimi dhe e keqja e tij janë të sigurta, ndërsa drejtësia dhe e mira e tij shpresohen. Pasuria e tij shpenzohet, mirësia e fjalës së tij është e kufizuar dhe pjesa e tij në këtë botë është furnizimi. Gjatë gjithë jetës së tij ai nuk ngopet me dije; poshtërimi për hir të Zotit, është më i dashur për të, se sa kur të tjerët e nderojnë. Përvulësia është më e dashur për të, se sa nderi që i bëjnë të tjerët për një shërbim të vogël që u bën atyre.

63- O Hisham! Nuk ka fe për atë që nuk ka moral; nuk ka moral për atë që nuk ka intelekt. Më i madhi i njerëzve në vlerë është ai që nuk sheh rrezik për veten e tij në dynja. Për sa u përket trupave tuaj, nuk ka çmim tjetër për ta përveç Xhenetit, prandaj mos i shitni për asgjë tjetër përveç tij (Xhenetit). Të jesh fqinj i mirë, nuk do të thotë të përmbahesh nga të bërit keq, por të jesh fqinj i mirë, do të thotë të jesh i durueshëm ndaj të bërit keq.

64- O Hisham! Epërsia e dijetarit ndaj adhuruesit është si epërsia e hënës mbi të gjithë yjet në një natë me hënë të plotë.

65- O Hisham! Njeriu bujar dhe i sjellshëm është nën mbrojtjen e Allahut dhe Ai nuk e braktis atë, deri sa ta fusë në Xhenet. Profetët e Allahu ishin bujarë. Babai im, deri sa ai ndërroi jetë, më porosiste të jem bujar dhe i sjellshëm.

66- O Hisham! Ruhu nga lakmia dhe dëshpërimi nga ajo që është në duart e njerëzve dhe jepi fund lakmisë mes krijesave, sepse lakmia është çelësi i poshtërimit, shkatërron intelektin, trillon personalitetin, përdhos nderin dhe largon diturinë. Kapu fort pas Zotit tënd dhe mbështetu tek Ai. Luftoje veten tënde që ta

zbrapsësh atë nga dëshirat e saj, sepse kjo është e detyrueshme për ty, njëjtë si lufta kundër armikut tënd.

67- O Hisham! Ruhu nga dynjaja dhe nga banorët e saj, sepse njerëzit në të janë katër llojesh: një njeri i pabindur, përqaftues i dëshirave të tij; një nxënës i mësuar, i cili sa më shumë i shtohet dituria, i shtohet mendjemadhësia dhe e sheh veten më lart se njerëzit me leximin dhe diturinë e tij; një adhurues injorant, që i shikon me përçmim ata që janë nën të se ai në adhurimin e tij dhe i pëlqen të madhështohet dhe të nderohet; ai që ka mendjemprehtësi, dijetar dhe njohës i

rrugës së vërtetë. Atij i pëlqen të ftojë te e vërteta, por është i pafuqishëm ose i mposhtur. Ai nuk është në gjendje të bëjë atë që di, prandaj është i trishtuar dhe i pikëlluar për shkak të kësaj. Për këtë ai është shembulli më i mirë për njerëzit e kohës së tij dhe më i zgjuari prej tyre.

68- O Hisham! Njihe intelektin dhe “ushtritë” e tij, injorancën dhe “ushtritë” e saj dhe do të jesh ndër të udhëzuarit.

- U bëfsha kurban për ty! - i tha Hishami. - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar.

- O Hisham! Allahu e krijoi intelektin dhe ai është krijesa e parë. Allahu e krijoi atë prej ruhanijinëve (njerëz në gradë të lartë shpirtërore) nga e djathta e Arshit dhe nga drita e Tij. Allahu i tha intelektit: “Largohu!”. Ai u largua. Pastaj i tha: “Afrohu!” Ai u afrua. Allahu i Madhëruar tha: “Të kam krijuar një krijesë madhështore dhe të kam nderuar mbi të gjitha krijesat e Mia”. Pastaj Ai krijoi injorancën nga deti i njelmët dhe i errët. Ai i tha: “Largohu!” Ajo u largua. Pastaj i tha: “Afrohu!”, por nuk u afrua. Ai i tha: “Ti je mendjemadhe, prandaj të mallkoj”. Pastaj (Allahu) caktoi shtatëdhjetë e pesë ushtarë për intelektin. Kur injoranca pa se si Allahu e nderoi intelektin dhe ato që i dha atij, e fshehu përbrenda urrejtjen dhe armiqtësinë

ndaj tij (intelektit). Injoranca tha: “O Zot, kjo është një krijesë si unë, e ke krijuar, e nderove dhe e forcove. Unë jam kundër tij dhe nuk kam fuqi mbi të. Më jep një ushtri si ajo që i ke dhënë atij”. Allahu i Madhëruari i tha: “Po. Nëse më kundërshtoni Mua pas kësaj, Unë do të të largoj ty dhe ushtarët e tu nga mbrojtja dhe mëshira Ime”. Injoranca tha: “Pranoj”. Allahu i dha asaj shtatëdhjetë e pesë ushtarë. Nga shtatëdhjetë e pesë ushtarët që i dha intelektit, e mira është ministërja e intelektit. Të kundërtën e saj vendosi të keqen, që është ministërja e injorancës.

69- O Hisham! Njerëzit që ka kanë intelekt, kanë braktisur kuriozitetin ndaj dynjasë. Si të mos i braktisin mëkatet?! Braktisja e dynjasë është prej virtyteve dhe braktisja e mëkateve është prej detyrave.

70- O Hisham! Mesihu, Isai, i biri i Merjemes (*Paqja qoftë mbi ta!*), u tha apostujve: “Të mjerët ju, o sklleverit e dynjasë! Për shkak të mirësisë së paqëndrueshme dhe të dynjasë së përkohshme, ju ikni nga Allahu dhe e përbuzni takimin me Të. E si ta dojë Allahu takimin me ju, ndërkohë që ju e përbuzni takimin e Tij?! O ju që e adhuroni këtë botë! As nuk mendoni si zotëruesit e urtësisë, as

nuk kuptoni si të mençurit, as nuk dini si dijetarët, as nuk jeni si ata që ruhen prej të këqijave dhe as nuk u përngjani njerëzve të lirë e me vlerë. Nuk do të kalojë shumë dhe bota do t'ju gërmojë nga rrënja dhe do të shtriheni me shpinë në tokë. Pastaj, mëkatet tuaja do t'ju tërheqin zvarrë për flokësh, nga mbrapa do t'ju shtyjë dituria që nuk e keni shfrytëzuar dhe do t'ju dorëzojë lakuriq dhe të vetmuar te Sunduesi, që do t'ju ndëshkojë. Ai do t'ju ndëshkojë për veprat e këqija. O rob të këqij! Ditën e Gjykimit, si mund të shpresoni sigurinë prej frikës së Allahut, kur ju frikësoheni nga njerëzit?! Çfarë është më e keqja, ju u nënshtroheni njerëzve dhe përmbushni premtimet e atyre që janë në kundërshtim

me premtimet e Allahut. O robtë e kësaj bote! Për t'u treguar si asketë, ju e ruani kokën tuaj, i shkurtoni këmishët tuaja dhe i ulni kokat. Por xhelozinë dhe lakminë nuk e nxirrni dot nga zemrat tuaja. O robtë e kësaj bote! Ju u përngjani varrezave të lyera me allçi, që të mahnitin kur i shikon nga jashtë, ndërsa brenda tyre gjenden eshtrat e mbushura plot me mëkate.

Sa të mrekullueshme janë porositë dhe këshillat!

Allahu na bëftë prej dëgjuesve, kuptuesve dhe zbatuesve të porosive të

.....

njerëzve të mëdhenj e të dashur te Allahu i Madhëruar!

Në Kur'anin e Shenjtë thuhet:

{...فَبَشِّرْ عِبَادِي الَّذِينَ يَسْتَمِعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَاهُمُ اللَّهُ وَأُولَئِكَ هُمْ أُولُوا الْأَلْبَابِ }

“Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhet), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët”.²⁴

²⁴ Sure “Ez Zumer”, ajetet 17-18.

Porosi të Imam Kadhimit (*Paqja çoftë mbi të!*)

اسم الكتاب: من وصايا الإمام كاظم عليه السلام للهشام

ترجمة سفارشات ها: الشيخ ولنت (عباس) مریا

التصحیح الاذنی: یریدا کولا

التصحیح اللغوی: ویولسا کارای

الإخراج النهائي: صبریه فزا

الغلاف: صبریه فزا

الناشر: جمعیت نسیم

تیرانا: 2023